(57)1. Një aparat tensionimi për aplikimin e tensionit në litarë (20) të cilët furnizohen në një makinë thurjeje për prodhimin e rrjetave metalike për mbrojtje gjeoteknike, ku në rrjetat metalike ka tela metalikë të ndërthurur me njëri-tjetrin në makinën e thurjes (14) të cilët janë të ndërthurur me litarë metalikë (20) , ku aparati tensionues përfshin një rul devijues hyrës (220) dhe një rul devijues dalës (226) , në seksionin midis rullit devijues hyrës (220) dhe rullit devijues dalës (226) , telat (14) kalojnë në mënyrë drejtvizore dhe pa asnjë pengesë ndërsa litarët (20) janë të përfshirë me një pajisje tensionimi (228) e cila është parashikuar për të aplikuar në litarë (20) një tension shtesë specifik, ku pajisja tensionuese (228) ka një grup tamburësh (230) , rreth të cilave janë mbështjellë një ose më shumë spirale të litarëve (20) që do të vendosen nën tension, ku elementë tensionues (250) që i mbajnë spiralet në kontakt me tamburet në një mënyrë të tillë që të rregullojnë fërkimin midis litarëve (20) dhe tambureve në mënyrë që të gjenerojnë një forcë të kundërt me veprimin tërheqës që aplikohet nga makina e thurjes dhe që tenton të lirojë litarët (20) nga fuçitë e pajisjes së tensionimit (228) .

2. Një aparat tensionimi sipas pretendimit 1, ku tamburët (230) janë të rrotullueshëm.

3. Një aparat tensionimi sipas pretendimit 2, ku tamburët (230) janë të gjithë të fiksuar në një bosht të rrotullueshëm (236) në mënyrë që të jenë të rrotullueshëm me lëvizje sinkrone.

4. Një aparat tensionimi sipas pretendimit 3, ku pozicioni i secilit tambur (230) është i rregullueshëm përgjatë aksit gjatësor të boshtit.

5. Një aparat tensionimi sipas pretendimit 3 ose pretendimit 4, ku boshti i rrotullueshëm (236) është i pajisur me një pajisje frenimi (240) e cila është e pajisur për të ngadalësuar dhe/ose frenuar në mënyrë selektive rrotullimin e boshtit.

6. Një aparat tensionimi sipas pretendimit 5, ku pajisja e frenimit (240) përfshin të paktën një disk freni i cili është montuar në bosht në mënyrë koaksiale, ku të paktën një nofull freni është në gjendje të kontrollohet në mënyrë që të fiksojë në mënyrë selektive diskun e frenave në mënyrë që të frenojë dhe/ose të ngadalësojë rrotullimin e boshtit në të cilin janë montuar tamburet.

7. Një makinë thurjeje (10) për prodhimin e një rrjete metalike të përforcuar (12) për mbrojtje gjeoteknike e cila përfshin një mori telash metalikë (14) të cilët janë të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe me litarë metalikë (20) në mënyrë që të përcaktojnë nyjen e rrjetës, që përfshin, në rrjedhën e sipërme të një pajisjeje thurjeje, një aparat tensionues (200) sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshme i cili është parashikuar për të aplikuar një tension në litarët metalikë (20) të cilët furnizohen me makinën në mënyrë që të mbajnë litarët metalikë më drejtvizorë se telat metalikë (14) në formimin e nyjes së rrjetës së përforcuar.

8. Një metodë për prodhimin e një rrjete metalike të përforcuar (12) për mbrojtje gjeoteknike, ku janë të ndërthurur me njëri-tjetrin në një makinë thurjeje tela metalikë (14) të cilët janë të ndërthurur me litarë metalikë (20) , ku telat metalikë (14) ecin në mënyrë drejtvizore dhe pa asnjë pengesë në një aparat tensionimi të makinës së endjes, ndërsa litarët përforcues (20) janë të përfshirë me një pajisje tensionimi (228) të aparatit tensionues i cili aplikon në litarët përforcues (20) një forcë tensionimi të kundërt me veprimin tërheqës me të cilin makina e endjes merr litarët metalikë që i furnizohen asaj.

9. Një metodë sipas pretendimit 8, ku forca e kundërt që aplikohet në litarët metalikë (20) shkaktohet nga fërkimi i litarëve metalikë (20) në sipërfaqet përkatëse tensionuese.

10. Një metodë sipas pretendimit 9, ku sipërfaqet tensionuese përcaktohen nga mbulesa cilindrike (234) e tamburëve (230) rreth të cilëve janë mbështjellë një ose më shumë spirale të litarëve metalikë (20) .

(22) 31.03.2026

(21) [AL/P/2026/214](#)

(54) **PËLHURË PËR VESHJE NOTI PAMBUKU**

(30) GR 20240100506 19/07/2024

(71) SPIROS FRAGOS & SIA E.E. - PEPPER VALLY/I Striftou 43 Acharnes 13673 Athens, GR GR

(72) Spyridon FRAGKOS/Pefkon 19, 13677 Acharnes Athens Greece,

Aliki GKORITSA/Pefkon 19, 13677 Acharnes Athens Greece.

(57) Kjo shpikje propozon një pëlhurë për veshje noti që është bërë nga pambuk dhe nderkaq ruan të gjitha karakteristikat e kërkuara për një veshje noti si elasticiteti, ajrosshmëria dhe aftësia për tu tharë shpejt, ndërkohë që lejon qarkullimin e ajrit për një rehati totale, optimizon kontrollin e lagështirës, i jep përparësi mbrojtjes së lëkurës dhe kontribuon në ruajtjen e ekosistemit të planetit, sepse pambuku është një lëndë e parë e bio-degradueshme që i kthehet tokës atje ku përdoret pa i shkaktuar probleme kur shpërbëhet. Qëllimi ynë është të krijojmë një pëlhurë për veshje noti që i plotëson të gjitha karakteristikat që një pëlhurë për veshje noti duhet të ketë. Pas shumë kërkimesh arritëm në zgjidhjen që të përdorim si material lëndë e parë, fill pambuku të krehur me fije të gjatë të kaluar në gaz dhe mercerizuar me përdredhje thurjeje që nuk përdoret për të krijuar pëlhurën por vetëm për thurje dhe së bashku me fije gome natyrale 1% - 5% në një strukturë specifike pëlhure që zhvilluam. Kjo strukturë e veçantë pëlhure eliminon problemet e krijuara nga një fill i tillë kur përdoret për ndërtimin e pëlhurës dhe i jep karakteristika shtesë të tilla si elasticiteti, kalim më i shpejtë i ajrit për një rehati totale dhe tharje e shpejtë. Rezultati është një pëlhurë për veshje noti natyrale që përmbush specifikimet e veshjeve të notit duke përdorur një lëndë të parë filli specifike dhe strukturë pëlhure specifike.

Përshkrimi Fusha teknike të cilës i referohet kjo shpikje është ajo e pëlhurave të tekstilit për veshje noti me elasticitet. Shpikja në fjalë lidhet me pëlhurën e tekstilit të përbërë nga pambuku ndërkohë që ruan të gjitha karakteristikat e kërkuara të veshjes së notit të tilla si elasticiteti, aftësia për tu ajrosur dhe për tu tharë shpejt, ndërkohë që lejon qarkullimin e ajrit për një rehati totale, optimizon kontrollin e lagështisë, i jep përparësi mbrojtjes së lëkurës dhe ndikon në ruajtjen e ekosistemit të planetit, sepse pambuku është një lëndë e parë e biodegradueshme që i kthehet tokës ku përdoret pa shkaktuar probleme kur dekompozohet. Shpikja trajton specifikisht sfidën teknologjike të krijimit të një pëlhure për veshje noti me bazë pambuku që arrin karakteristika performance të mundura më parë vetëm me materiale sintetike, nëpërmjet një kombinimi të ri të një konstruksioni fijeje dhe një teknike të re thurjeje tre-dimensionale. Industria e tekstileve është e njohur me përfitimet e shumta të lëndëve të para natyrale ndaj lëndëve të para sintetike për përdoruesin njeri dhe për ruajtjen e ekosistemit të planetit tonë. Lërë më në industrinë e veshjeve të notit e cila deri më sot i ka bërë ekskluzivisht me lëndë të para sintetike, përveçse pak përjashtime që ekzistojnë, por që nuk i arrijnë karakteristikat e kërkuara që një veshje noti duhet të ketë, të tilla si elasticiteti, qëndrueshmëria, tharja e shpejtë, rezistenca ndaj ujit. Shpikja në fjalë synon të zgjidhë disavantazhet e mësipërme duke propozuar një pëlhurë veshjeje noti të bërë me pambuk ndërsa ruan të gjitha karakteristikat e kërkuara të një veshje noti të tilla si elasticiteti, tharja e shpejtë, rezistenca ndaj ujit dhe për më tepër me aftësi ajrosjeje të lartë që lejon qarkullimin e ajrit për një rehati totale dhe optimizim të kontrollit të lagështisë. Përshkrimi i shkurtër i shpikjes Kjo pëlhurë për veshje noti është e përbërë nga 100% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz dhe i mercerizuar në një strukturë me

dopjo-thurje tre-dimensionale. Kemi parë një një realizim tjetër që kemi karakteristika më të mira mbi pëlhurën duke përdorur 100% pambuk të krehur me fije të gjatë të kaluar në gaz dhe mercerizuar me përdredhje të qepjes në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale. Kemi parë një një realizim tjetër që kemi karakteristika më të mira mbi pëlhurën duke përdorur 95% deri 99% pambuk të krehur me fije të gjatë të kaluar në gaz dhe mercerizuar me përdredhje të qepjes dhe 1% deri në 5% fije gome natyrale në një strukturë dopjo-thurjeje tre dimensionale. Kemi parë një një realizim tjetër ku sërisht kemi karakteristika më të mira mbi pëlhurën duke përdorur fije me finesë numër Ne2/28 deri në Ne2/38 prej pambuku të krehur me fije të gjata të kaluar në gaz dhe mercerizuar me përdredhje të qepjes dhe fije me finesë numër Ne2/16 deri në Ne2/38 prej gome natyrale. Gjithashtu kemi parë në një realizim tjetër që kemi disa karakteristika nëse përdorim një fije gome sintetike në vend të fijos së gomës natyrale. Metoda e prodhimit të kësaj pëlhure për veshje noti është karakterizuar nga struktura e dopjo thurjes tre-dimensionale me një sekuençë rrotulluese të gjilpërave në të dyja shtratet e gjilpërave të makinës thurëse, sekuenca e alternimit të gjilpërave të përdorura, neutralizimin e forcave kundërshtuese të krijuara nga fija me përdredhje qepjeje dhe përdrimi specifik i makinave thurëse të rrafshëta me kalibër Nr 12. Struktura e dopjo-thurjes tre-dimensionale përfshin specifikisht: Makinën thurëse kalibër Nr 10 deri në Nr 16, preferueshëm kalibër Nr 12. Vendosija e gjilpërave: Sekuenca alternuese në të dyja shtratet Pikat e bashkimit: Shpërndarja e sekuençës alternuese çdo 2-8 gjilpëra Ndarja e shtresave: 0.5-3.2mm Veshja e notit e bërë nga fije 95% deri në 99 % pambuk i krehur i kaluar në gaz dhe i mercerizuar me fije të gjatë me përdredhje të thurjes dhe 1 deri 5% fije gome natyrale në një strukturë dopjo-thurjeje tre-dimensionale/pëlhurë e thurur dy shtresore tre-dimensionale. Kjo thurje e veçantë eliminon problemet e shkaktuara nga një fill i tillë me përdredhje thurjeje kur përdoret për ndërtimin e pëlhurës nëpërmjet neutralizimit të forcave kundërshtare që zhvillohen në strukturën e pëlhurës duke përdorur dy shtrate gjilpërash nga makina thurëse nëpërmjet alternimit të gjilpërave të përdorura me një sekuençë rrotullimi të gjilpërave në të dy shtratet e gjilpërave nga makina thurëse. Sekuenca rrotulluese e gjilpërave specifikisht neutralizon forcat kundërshtare dhe tensionet deformuese nga fija me përdredhje qepjeje, që është thelbësore për: Qëndrueshmërinë e pëlhurës gjatë prodhimit, qëndrueshmërinë e pëlhurës pas përdorimit të zgjatur, parandalimin e deformimit diagonal dhe ruajtjen e karakteristikave të elasticitetit. Kemi parë në një realizim tjetër që kemi efektin e dëshiruar në pëlhurë kur fija prej pambuku të krehur me fije të gjatë e kaluar në gaz dhe e mercerizuar me përdredhje të qepjes është nga fije me finesë numër Ne 2/28 deri në Ne 2/38. Ne(numër në Anglisht) është sistemi numerik standard i fijos që shpreh finesën e fijos, ku numri përfaqëson gjatësinë e fijos në lëmshe (840 jardë) për paund. Numri Ne më i lartë tregon fije më fine. Kemi parë një një realizim tjetër që kemi efektin e dëshiruar në pëlhurë kur finesa e fijos së gomës natyrale është nga Ne2/16 deri në Ne2/38. Kemi parë një një realizim tjetër që kemi të njëjtin efekt të dëshiruar në pëlhurë kur goma e përdorur është gjithashtu sintetike në fije me finesë numër nga Ne2/16 deri në 2/38. Përshkrimi i figurave Figura 1 përshkruan pëlhurën dy shtresore tre-dimensionale me një sekuenca rrotulluese gjilpëre që është rezultat i strukturës së thurjes së dyfishtë tre-dimensionale. Figura 2 përshkruan rrugëtimet e fijos në të dy shtratet e gjilpërave të makinës thurëse duke alternuar gjilpërat e përdorura me një sekuençë rrotulluese në të dyja shtratet e gjilpërave të makinës thurëse. Figura 3 tregon një përfaqësim skematik të sytheve. Përshkrimi analitik dhe rezultatet eksperimentale Aktualisht, pjesa më e madhe e pëlhurave në treg janë të bëra nga materiale sintetike të tilla si poliestër, najlon(poliamide), dhe spandex (elastan). Këto materiale favorizohen nga karakteristikat e qëndrueshmërisë, tendosshmërisë dhe tharjes së shpejtë, dhe rezistenca ndaj klorit dhe ujit me kripë. Gjithsesi, ato nuk janë miqësore


me mjedisin sepse derivojnë nga burime me bazë benzinën, të cilat kontribuojnë në degradimin e mjedisit gjatë nxjerrjes dhe prodhimit. Për më tepër, pëlhurat sintetike lëshojnë mikroplastikë në ujë gjatë larjes, duke ndotur kështu ekosistemet marine. Këto materiale janë gjithashtu jo-të biodegradueshme, duke shkaktuar mbetje afatgjata nëpër landfille. Nga pikëpamja e shëndetit, pëlhurat sintetike shpesh përmbajnë shtesa kimikate, të tilla si bojë dhe agjente përfundimi, të cilët mund të shkaktojnë irritime të lëkurës ose alergji për individët, duke i bërë ato më pak ideale për shëndetin e lëkurës dhe trupit. Materialet Tradicionale të Veshjeve të Notit dhe Problemet e Tyre: 1. Impakti mbi mjedisin: Najloni: Krijon oksid azoti (310 herë më i fuqishëm sesa CO₂ si gaz serrë) Poliestra: Kërkon sasi të mëdha të ujit për tu ftohur dhe përdor lubrikantë të dëmshëm Spandeksi: i renditur Klasa E (më pak i qëndrueshmi) në standardet mjedisore Të gjitha materialet sintetike lëshojnë mikroplastikë në oqeanë 2. Shqetësimet mbi shëndetin: Pëlhurat sintetike përmbajnë “kimikate të përhershme” të cilat çlirohen gjatë veshjes Mund të rrisin rezikun e sëmundjeve të lëkurës Kimikatet vazhdojnë të çlirohen në çdo cikël larje/tharje Ajrosshmëri e dobët që prek shëndetin e lëkurës 3. Problemet e qëndrueshmërisë: Konsum i lartë energjie në prodhim Materiale jo-të biodegradueshme Ndotje e ujit gjatë prodhimit . Varesi e lartë nga produktet me bazë benzine Kjo shpikje lidhet me zhvillimin e një pëlhure të bërë nga fibra natyrale, specifikisht e projektuar për tu aplikuar në veshje noti, duke kombinuar avantazhet ekologjike të materialeve natyrale me karakteristikat funksionale që janë të zakonshme tek pëlhurat sintetike. Kjo pëlhurë ka rezistencë të lartë ndaj ujit, elasticitet të lartë dhe thahet shpejt, ndërkohë që ruan stabilitet dimensional dhe qëndrueshmëri kur përdoret në kushte notimi. Risia e kësaj shpikjeje qëndron në përdorimin e materialeve natyrale të trajtuara në mënyrë speciale, të tilla si pambuku (pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz dhe i mercerizuar me përdredhje qepjeje) në kombinim me gomën natyrale. Këto materiale i nënshtrohen një procesi special teknologjik thurjeje dhe testeve të qëndrueshmërisë, që siguron karakteristika që normalisht i kanë fibrat sintetike. Struktura e pëlhurës dhe metodat e thurjes janë zgjedhur me kujdes për të siguruar karakteristika të përshtatshme për përdorim në notim. Lëndët e para: Karakteristikat dhe Kategoritë Pambuk i krehur: Është një fibër natyrale e cilësisë së lartë, që i nënshtrohet një trajtimi mekanik special për ti hequr fibrat më të shkurtra, duke rritur kështu qëndrueshmërinë dhe butësinë e pëlhurës. Pambuku i krehur është jetëgjatë dhe rezistent për tu veshur dhe ndaj grisjes është më i qëndrueshëm sesa të gjitha varietetet e tjera dhe siguron një nivel të lartë qëndrueshmërie dhe ajrosshmërie në produktin e përfunduar, ndërkohë që shkëlqimi është ideal për përdorim në notim. Pambuku me fije të gjatë: karakterizohet nga karakteristikat ne vijim: Qëndrueshmëri e Lartë: i reziston veshjes dhe grisjes dhe zgjat më shumë. I qëndrueshëm dhe zgjat më shumë. Ndjesi butësie si mëndafsh. Përthithshmëria dhe Ajrosshmëria: Përthith lagështinë dhe ajroset, duke siguruar rehati. Rezistenca ndaj Nxehtësisë dhe Njollave: Reziston ndaj nxehtësisë dhe njollave. Mbajtja e formës: Tregon më pak tkurrje dhe shkriftim. Shkëlqimi natyral: Ka një shkëlqim delikat që i jep elegancë. Pambuku i kaluar në gaz dhe i mercerizuar: Nga metoda e procesimit të mercerizimit, pambuku trajtohet kimikisht me sodë kaustike për të rritur fuqinë, qëndrueshmërinë dhe shkëlqimin. Ky lloj pambuku ofron një rritje të qëndrueshmërisë dhe parandalon tejmbushjen në kushte të ujit. Fija e kaluar në gaz e përdorur është trajtuar në mënyrë speciale për të reduktuar thithshmërinë dhe për të rritur rezistencën e pëlhurës ndaj tensionit në tërheqje. Goma natyrale: E përdorur në përqëndrime të vogla (1-5%) për ti siguruar elasticitet pëlhurës. Është shumë rezistente ndaj ujit dhe ndihmon në ruajtjen e integritetit struktural të pëlhurës edhe kur laget. Ofron stabilitet dimensional dhe rikthen formën origjinale pas përdorimit. Prosesi i Prodhimit të Pëlhurës: Teknologjitë dhe strukturat e thurjes Pëlhura është prodhuar në makinat thurëse STOLL CMS TC, të cilat

sigurojnë fleksibilitet dhe precision në një gamë të gjerë strukturash dhe kalibri thurjeje. Kalibri i makinës në makinat thurëse është një masë që shpreh numrin e gjilpërave për 1 inch të gjerësisë së shtratit të gjilpërës. Makinat që u përdorën për të thurur ishin të klibrir Nr.5 deri në Nr.14, duke lejuar krijimin e pëlhurave me dendësi dhe trashësi të ndryshme. Strukturat e thurjes të përdorura përfshijnë: Struktura teke dhe dopjo thurjeje: Ato ofrojnë qëndrueshmëri dhe stabilitet të lartë, ndërkohë që përmirësojnë elasticitetin e pëlhurës. Struktura dopjo-thurje përdoret për të krijuar një pëlhurë më kompakte me stabilitet më të lartë, ideale për aplikime që kërkojnë një përputhje në veshje dhe qëndrueshmëri. Pëlhura e thurur me dy shtresa/struktura dopjo-thurje dhe struktura rib: Këto struktura kontribuojnë në elasticitetin dhe qëndrueshmërinë e pëlhurës dhe rimarrjen e shpejtë të formës. Struktura rib, veçanërisht, përmirëson elasticitetin, fleksibilitetin dhe lehtësinë e lëvizjes. Këto struktura përmirësojnë aftësinë e pëlhurës për tu përshtatur dhe ruajtur elasticitetin edhe pas përdorimit të zgjatur në ujë. Struktura dopjo-thurje tre-dimensionale: Një teknikë inovative që krijon një material që ruan stabilitetin e tij pavarësisht tendosjeve të përsëritura, ndërkohë që sekuenca e gjilpërave rrotulluese neutralizon forcat kundërshtarë që zhvillohen nga përdredhjet e qepjes të fillit. Ky rregullim është kritik për të parandaluar deformimin diagonal të pëlhurës. Gjithashtu kjo strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale krijon hapësira ajri që lejojnë një ajrosje më të mirë të trupit dhe tharje të shpejtë të pëlhurës. Testet eksperimentale Fillimisht, përdorimi i gomës natyrale dhe gomës sintetike u testua në përqëndrime të ndryshme në pëlhurën e prodhuar. U zgjodh një përqindje prej 1%-5% sepse më shumë se 5% nuk e përmirëson më tej elasticitetin e pëlhurës dhe më pak se 1% e redukton elasticitetin e dëshiruar të pëlhurës. Faza e Parë e Testimit: 100% pambuk i krehur Në këtë fazë, u kryen 100 teste eksperimentale duke përdorur 100% pambuk të krehur me përdredhje të qepjes në finesa të ndryshme të fijos nga Ne20/2 deri në Ne 36/2 me 1%-5% fije elastike. U krijuan struktura të pëlhurës me teknika të ndryshme thurjeje, të tilla si, struktura thurjeje teke dhe dopjo dhe struktura rib në kombinime të ndryshme. Për të prodhuar këto pëlhura u përdorën STOLL CMS TC nga kalibri Nr 5 deri në Nr 16. Rezultatet: U përmirësua ndjeshëm elasticiteti i pëlhurës, megjithëse u vu re një rezistencë e vogël nga uji. Kur pëlhura u lag, elasticiteti dhe qëndrueshmëria e pëlhurës u reduktua dukshëm, ndërkohë që tharja ishte e ngadaltë dhe elasticiteti nuk ishte rikthyer plotësisht. Makinat thurëse me kalibër Nr 5 dhe Nr 7, dhe finesë të fillit Ne 20/2 deri në Ne 26/2 u hoqën sepse pëlhura e prodhuar prej tyre ishte tejet e trashë dhe e përhumbur për tu veshur. Faza e Dytë e Testimit: 100% Pambuk Krep Në fazën e dytë, u kryen 80 prova me 100% pambuk krep me finësë të fijos nga Ne28/2 deri në Ne 36/2 dhe 1-5% fill elastik. Për të prodhuar këto pëlhura u përdorën makinat thurëse STOLL CMS TC me kalibër Nr 10 deri në Nr 14. Rezultatet: U përmirësua më tej elasticiteti i pëlhurës, ndërkohë që u rrit rezistenca ndaj ujit. Pëlhura e ruajti elasticitetin kur pëlhura ishte e lagur, edhe pse koha e tharjes mbeti e ngadaltë. Pëlhurat me finesë filli nga Ne 28/2 deri në Ne 32/2 dhe kalibër Nr 14-16 u hodhën për shkak të transparencës së tepërt kur lageshin. Faza e Tretë e Testimit: U përdor 100% pambuk i kaluar në gaz i mercerizuar me përdredhje thurjeje dhe finesë të fillit Ne 33/2 deri në Ne36/2 me makina thurëse kalibër Nr 10 dhe Nr 12. Rezultatet: Një përmirësim i elasticitetit dhe rezistencës nga uji, me kohë të ndryshme tharjeje në varësi të strukturës së thurjes dhe finesës së fillit. Pëlhura mbeti stabël në dimensione pas përdorimit të përsëritur edhe pse rezistenca nga uji nuk ishte në të njëjtin nivel të pëlhurës sintetike. Faza e Katërt e Testimit: U përdor 100% pambuk i kaluar në gaz i mercerizuar me përdredhje thurjeje Për të përmirësuar më tej rezistencën nga uji, u përdor 100% pambuk i krehur me fije te gjatë i kaluar në gaz dhe i mercerizuar me përdredhje thurjeje me finesë të fillit Ne2/34 deri në Ne 2/36. Këto përdredhje ofrojnë qëndrueshmëri edhe në kushte thatësie edhe lagështie. Përcaktimi i Parametrave të Testit:


Rezistenca nga uji: Aftësia e pëlhurës për ti rezistuar përthithjes së ujit Elasticiteti: Aftësia e pëlhurës për tu zgjatur dhe për tu rikthyer Stabiliteti dimensional: Aftësia e pëlhurës për të ruajtur përmasën dhe formën Qëndrueshmëria: Rezistenca për tu veshur dhe dëmtimi nga përdorimi në kushte notimi MATJET E PËRDREDHJES: Filli i kësaj shpikjeje (Ndërtimi i Fillit të Thurjes): Përdredhje Z: 800-900 TPM (20-23 TPI). Ne 2/35, Fortësia : 980 cN – 30 RKM, Elasticiteti 6.2% SPECIFIKAT E FIJES : A. Ndërtimi i Fillit të Thurjes: Lloji: Pambuk i krehur me fije të gjatë (ELS). Përpunimi: i kaluar në gaz dhe i mercerizuar. Ndërtimi: Konfigurim fije thurjeje me shtresë të shumëfishtë. B.1. Parametrat Kritike te Fillit te Thurjes: Drejtimi i përdredhjes: Përdredhje Z. 800-900 TPM (20-30 TPI). Më e lartë sesa standardi i fillit të thurjes. Faktor përdredhjeje më i lartë për përmiresim të fortësisë. Ose B.1.Parametrat Kritike të Fillit te Thurjes: Drejtimi i përdredhjes: Tipikisht përdredhje Z/S në dy stade. Përdredhja primare (teke): drejtimi Z. Përdredhja Finale dyfishe: drejtimi S. Koeficienti i Përdredhjes: Më i lartë sesa fija standard e thurjes. Faktor përdredhjeje më i lartë për fortësi më të madhe. C. Avantazhet Teknike Specifike: Rezistencë abrazioni e përmirësuar për qëndrueshmërinë e qepjes. Formim sythash i përmirësuar në thurjen teknike. Rezistencë më e mirë në tërheqje për stabilitet struktural. Butesi superiore në sipërfaqe nga procesi i kalimit në gaz. Gjithsesi, u vu re se pëlhura tregoi instabilitet vertikal për shkak të përdredhjeve të ndryshme, gjë që çoi në deformim diagonal nga përdorimi. Zgjidhja e problemit: Pas kërkimeve të mëtejshme, u zhvillua një strukturë e re një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale me një sekuencë rrotulluese gjilpëre në të dy shtratet e gjilpërave të makinës thurëse e cila neutralizon forcat kundërshtuesetë zhvilluara në strukturën e pëlhurës të shkaktuar nga përdredhjet e fillit. Duke siguruar kështu stabilitetin e pëlhurës edhe gjatë prodhimit edhe pas përdorimit të zgjatur. Rezultati optimal: Pëlhura optimale e krijuar me finesë filli Ne 2/35 ne makinë thurjeje me kalibër Nr 12 dhe strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale me një sekuencë rrotullimi gjilpëre në te dy shtratet e gjilpërave të makinës thurëse. Kjo pëlhurë është një formë dhe nenklasë e pëlhurës prej pambuku të veshjes së notit që kemi depozituar fillimisht për një patentë në 19 Korrik 2024 tek OBI me çështje Nr.:000002645 dhe Numer Aplikimi: 20240100506. Vlerësimi Eksperimental Të gjitha testet u kryen nën kushte reale notimi në det të kripur dhe ujë pishine, me kohëzgjatje që variuan nga 5 deri në 60 minuta. Rezultatet u krahasuan me testet korresponduese në pëlhura sintetike veshjesh notimi, me pëlhurën natyrale që i qasej karakteristikave të materialeve sintetike, ndersa ruanin karakteristikat dhe avantazhet ekologjike të pelhurës natyrale. Konkluzione Kjo pëlhurë finale dëshmon karakteristikat që e bejnë një alternativë të shkëlqyer ndaj materialeve sintetike për përdorim në notim. Zgjedhja e materialeve natyrale si lëndë e parë dhe teknologjia speciale e thurjes janë kombinuar për të siguruar qëndrueshmëri, përshtatshëri dhe performancë, ndërkohë që ofrohen avantazhe ekologjikisht miqësore. Aplikimi në veshje për notim mund të përmirësojë qëndrueshmërinë në prodhim dhe të ofrojë një perspektivë të re për industrinë në sektorin e veshjeve për notim dhe veshjeve sportive. FJALORI i TERMAVE TEKNIKË 1. Kalibër: Numri i gjilpërave për inch (siç përmendet në tekst: kalibër Nr.5 deri ne Nr.16), që përcakton densitetin dhe finesën e pëlhurës. 2. I kaluar ne gaz: Një process ku filli kalon në një flakë gazi për të djegur fibrat që dalin jashtë, duke krijuar një sipërfaqe të lëmuar (referuar në seksionin e materialeve lëndë e parë). 3. Mercerizuar: Trajtim kimik i pambukut me sodë kaustike (siç përshkruhet në seksionin e materialeve lëndë e parë) për të rritur: Fortësinë Qëndrueshmërinë Shkëlqimin 4. Strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale: Siç referohet përgjatë tekstit, specifikisht i referohet: Dy shtresave të veçara të pëlhurës Të lidhura përmes pikave specifike lidhëse Krijuar duke përdorur të dy shtratet e gjilpërave Duke përdorur sekuencë rrotulluese të gjilpërave 5. Sekuenca rrotulluese e gjilpërave: Siç përmendet në tekst, i referohet: Alternimit të zgjedhjes

së gjilpërave E përdorur në të dy shtratet e gjilpërave Neutralizon forcat kundërshtuese nga përdredhjet e thurjes 6. Terminologjia e Drejtimit të Përdredhjes: Siç përmendet në specifikimet e fillit Përdredhja Z: përdredhje spirale djathtas. Përdredhja S: përdredhje spirale majtas 8 .


1.



2.



3.



(57)1. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 100% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

2. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 100% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar me përdredhje thurjeje në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

3. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 95% deri 99% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar ose pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar me përdredhje thurjeje dhe 1% deri në 5% fill gome natyrale në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

4. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 95% deri 99% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar ose pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar me përdredhje thurjeje me finesë filli Ne2/28 deri në Ne2/38 dhe 1% deri 5% fill gome natyrale në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

5. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 95% deri 99% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar ose pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar me përdredhje thurjeje me finesë filli Ne2/28 deri në Ne2/38 dhe 1% deri 5% fill gome natyrale me finesë filli Ne2/16 deri në Ne2/38 në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

6. Pëlhurë për veshje noti me karakteristikat teknike. E bërë nga 95% deri 99% pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar ose pambuk i krehur me fije të gjatë i kaluar në gaz mercerizuar me përdredhje thurjeje me finesë filli Ne2/28 deri në Ne2/38 dhe 1% deri 5% fill gome sintetike me finesë filli Ne2/16 deri në Ne2/38 në një strukturë dopjo-thurje tre-dimensionale.

7. Metoda e prodhimit të pëlhurës për veshje noti sipas pretendimeve 1-6, karakterizuar nga: Sekuenca rrotulluese e gjilpërës në të dy shtratet e gjilpërave nga makina thurëse. Sekuenca e alternimit të gjilpërave e përdorur. Neutralizimi i forcave kundërshtuese e zhvilluar nga filli me përdredhje thurjeje. Përdorimi specifik i makinës së thurjes së sheshtë kalibër Nr 12.

**APLIKIME PËR REGJISTRIMIN KOMBËTAR TË
MARKËS TREGTARE**

(210) [AL/T/2025/909](#)

(220) 04.06.2025

(540)



(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(526) gin; Distilled and Bottled; Gosnisht; 700 ml; 47% VOL. ALC

(591) e bardhe, e zeze, gri

(730) GOSNISHT // Godina 3-katëshe në fshatin Gosnisht, Përmet, AL.

(740) Eno Dodbiba // Rruga "Zhegu", ndërtesa nr.1, hyrja nr.1, apartamenti nr.7, njësia administrative nr.1, Tiranë.

(511) 33 - Pije alkolike.

(210) [AL/T/2025/1594](#)

(220) 14.10.2025

(540)



(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(526) churros

(591) kafe, bezhe, jeshile, e bardhe

(730) Esmeralda Ruka // Rruga "Muhamet Gjollësia", ndërtesa 67, apartamenti 34, kati parë, Tiranë, AL.


(740) Albana Laknori // Rruga "Muhamet Deliu", pallati "Ndregjoni", apartamenti 36, Dajt, Tiranë

(511) 35 - Shërbime të shitjes me pakicë që lidhen me produktet e furës ofrim informacioni dhe këshillash tregtare për konsumatorët në zgjedhjen e produkteve dhe shërbimeve.

(210) [AL/T/2025/1625](#)

(220) 21.10.2025

(540)



(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(526) "të gjithë elementët verbale në karaktere standarte, elementët figurative të birrës me përjashtim të elementit Korça; ®

(591) E bardhë, e zezë, e kuqe, e artë; e gjelbërt.

(730) BIRRA KORÇA // Bulevardi "Fan S.Noli", zona kadastrale 8562, numër pasurie 8/271, Korçë, AL.

(740) Ilian Qelesi // Rruga "Dhimitër Denasi", 02330050, ndërtesa 11, hyrja 10, apartamenti 21, Korçë.

(511) 32 - Birrë

(210) [AL/T/2025/1758](#)

(220) 17.11.2025

(540)



(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(526) supertekniku

(591) Ngjyra e bardhë; ngjyra e kuqe;

(730) Supertekniku // Kompleksi residencial "Magnet", pallati Lura, rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, AL.

(740) Ilir Pustina // Rruga "Njazi Demi", pallati 15, apartamenti 12, 2609, Tiranë.

(511) 37 - Shërbime instalimi dhe riparimi shërbime të ndryshme riparimi, për shembull, në fushën e hidrosanitareve, pajisjeve elektroshtëpiake, instalimeve elektrike, instalimeve hidraulike, pajisjeve kompjuterike, pajisjeve telefonike, instrumenteve instalimi, mirëmbajtja dhe riparimi i hidrosanitareve, pajisjeve elektroshtëpiake, pajisjeve elektrike, pajisjeve kompjuterike Konsulencë në lidhje me instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e hidrosanitareve, pajisjeve elektroshtëpiake, pajisjeve kompjuterike instalimi, mirëmbajtja dhe riparimi i makinerive

(210) [AL/T/2025/1865](#)

(220) 05.12.2025

(540)

ZABÒ

(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(591) E ZEZË; E BARDHË.

(730) ZABO GARDEN // Njësia administrative nr. 5, rruga "Liman Kaba", rezidenca "Altana", kati 0, Tiranë, AL.

(740) Irena Dimushi // Rruga "Nikolla Lena", ndërtesa 61, hyrja 34, apartamenti 17, njësia administrative nr. 7, Tiranë.

(511) 35 - Prezantimi i mallrave në media komunikimi, për qëllime të shitjes me pakicë sigurimi i një tregu online për blerësit dhe shitësit e mallrave dhe shërbimeve ndihmë për menaxhimin e biznesit konsulencë për menaxhimin e biznesit shërbime franchising konsulencë për organizimin e biznesit menaxhimin e biznesit të hoteleve promovimin e shitjeve për të tjerët organizimi i panairove tregtare për qëllime komerciale ose reklamuese organizimi i ekspozitave për qëllime komerciale ose reklamuese demonstrim i mallrave dizenjimi i materialeve reklamuese shpërndarjen e materialit reklamues shërbimet e pekspozimit për qëllime reklamimi studime tregu reklamim / publicitet shërbimet e agjencisë së reklamave / shërbimet e agjencive publicitare dhenie me qira e

hapësirave reklamuese shërbime këshillimore për menaxhimin e biznesit konsulencë profesionale të biznesit informacion mbi biznesin informacion tregtar dhe këshilla për konsumatorët në zgjedhjen e produkteve dhe shërbimeve shërbime të ndërmjetësitit komercial shërbimet e lobimit komercial hulumtim marketingu marketing modelim për reklamim ose promovim të shitjeve organizimi i shfaqjeve të modës për qëllime promocionale Shërbime reklamimi dhe promovimi të mallrave dhe/ose shërbimeve përmes sponsorizimit të ngjarjeve sportive marrëdhëniet me publikun dhenie me qira materiale publicitare shërbime prokurimi për të tjerët [blerja e mallrave dhe shërbimeve për biznese të tjera] asistencë për menaxhim komercial apo industrial sigurimin e informacionit të biznesit nëpërmjet një faqe online (web site) shërbime të shitjes me pakicë për përgatitjet farmaceutike, veterinare dhe sanitare dhe furnizimet mjekësore.

43 - Shërbime restoranti shërbime të kafeterisë shërbime kafene shërbime hotelerie ushqim dhe pije për catering shërbime bar.

(210) [AL/T/2025/1908](#)

(220) 13.12.2025

(540)



(593) Markë figurë

(550) Markë Individuale

(591) Ngjyre ari metalik, argjendi metalik, vjollce e erret

(730) MULTIVERSEBEAR // Rruga "Fuat Toptani", ndërtesa 157, njësia bashkiake nr. 2, 1001, Tiranë, AL.

(740) Arnold Elezi//Rruga "Fuat Toptani", ndërtesa 157, njësia bashkiake nr. 2, 1001, Tiranë.

(511) 3 - 30141 parfumeri 030135 parfume 030100 vajra esencialë 030270 vajra esencialë për aromaterapi 030282 temjan agarwood 030095 temjan 030215 difuzorë aromash 030216 aromatizues ajri 030246 preparat aromatizues ambienti 030268 dyra aromatike që shkrihen 030220 qirinj masazhi 030197 faculeta me locion kozmetik 030071 kremra kozmetikë 030102 locione kozmetike 030255 ujë micellar 030078 preparat heqës grim 030285 bomba banje 030175 kripëra banje 030134 shampo 030231 balsam flokësh 030118 vajra kozmetikë 030055 krem kundër diellit

4 - 040015 qirinj 040105 qirinj të parfumosur 040121 qirinj soje 040114

dy lëndë për ndriçim 040029 dyra (material i papërpunuar) 040039 vajra për ndriçim 040040 gaz për ndriçim 040020 material ndezës (për ndezje qirinjsh / ambienti) 040057 dru i gatshëm për ndezje 040013 ndezës për zjarr 040076 qirinj të vegjël të natës

9 - 090658 programe kompjuterike të shkarkueshme 090717 aplikacione software të shkarkueshme 090591 software i regjistruar 090791 platforma software të regjistruara ose të shkarkueshme 090802 screensaver software i regjistruar ose i shkarkueshëm 090372 kompjuterë 090707 laptopë 090724 tableta 090719 telefone inteligjentë 090849 ora inteligjente 090806 kompjuterë të veshshëm 090748 syze inteligjente 090776 kufje për realitet virtual 090934 software i shkarkueshëm për ambiente virtuale 090929 veshje virtuale e shkarkueshme 090696 skedarë imazhi të shkarkueshëm 090695 skedarë muzike të shkarkueshëm 090950 skedarë video të shkarkueshëm 090657 publikime elektronike të shkarkueshme 090870 software për menaxhimin e transaksioneve kriptografike 090935 software për krijimin e nft-ve 090918 skedarë imazhi të verifikuar nga nft 090933 skedarë muzike të verifikuar nga nft 090842 kuleta elektronike të shkarkueshme 090928 pajisje hardware për kriptomonedha 090755 pajisje për verifikimin e identitetit me token sigurie 090637 etiketa elektronike (rfid/nfc) për mallra 090692 byzylykë identifikimi të koduar 090725 kartela kyç të koduara 090640 kartela inteligjente me çip 090788 robotë edukimi 090908 robotë humanoidë me inteligjencë artificiale për asistencë dhe argëtim 090822 robotë teleprezence.

11 - 110040 llamba ndriçimi 110024 llamba elektrike 110136 drita tavani 110133 llustra / kandilë varës 110367 llamba dysHEMEJE 110041 fenerë

ndriçimi 110355 fenerë me qirinj
110309 drita akvariumi 110344 drita
dekorative "fairy lights" / drita varg
110195 drita elektrike dekorative për
pemë / evente 110414 llamba LED
110333 pajisje ndriçimi LED 110402
llamba inteligjente 110399 shkopinj
ndriçues 110179 llampa me vaj 110021
llamba ndriçimi 110022 llamba elektrike
ndriçimi.

14 - 40034 monedha koleksionuese
140049 tokenë bakri 140152 distinktivë
prej metali të çmuar 140113 rruaza për
bizhuteri 140015 byzylykë 140019
brosha 140024 zinxhirë 140018 charms
bizhuterie 140177 varëse dekorative për
çelësa 140162 zinxhirë çelësash 140051
medalionet 140031 varëse 140107 unaza
140166 kuti bizhuterish 140145 kuti
prezantuese për ora 140057 ora 140016
ora dore 140017 rripa për ora 140059
xhama për ora 140060 mekanizma ore
140073 gurë gjysmë të çmuar 140074
gurë të çmuar 140055 metale të çmuara
(të papunuara ose të punuara pjesërisht)
140003 shufra metalesh të çmuara
140172 rrathë metalikë të çmuar për
çelësa 140146 figurinë metalike.

16 - 160095 libra 160189 broshura /
fletëpalosje 160331 libra komikë
160393 libra për ngjyrosje 160394 figura
për ngjyrosje 160030 piktura (të
kornizuara ose jo) 160147 foto të
printuara 160014 figura / ilustrime
160250 kartolina urimi 160174 kartolina
160007 postera 160175 material i
shtypur 160179 botime të shtypura
160243 revista 160033 periodikë
160337 buletine 160232 prospekt /
prezantime të shtypura 160360
fletëpalosje promionale 160080
katalogë produktesh 160172 orarë të
shtypur 160248 artikuj shkollorë 160354
karta koleksionuese (jo lojë) 160328
ngjitëse 160013 albume 160283
nënfilxhanë letre 160371 letër me fara
160209 artikuj shkrimi & zyre

(stationery) 160068 blloqe shënimesh /
fletore 160058 fletore shkrimi ose
vizatimi 160182 letër shkrimi 160023
tabela shkrimi 160343 instrumente
shkrimi 160136 materiale shkrimi
160242 stilolapsa 160302 sette shkrimi
160300 kuti shkrimi 160031 lapsa
160293 mprehës lapsash 160105 maja
lapsash 160359 marker, shënues
(materiale shkrimi) 160211 bojëra druri /
pastel 160124 materiale vizatimi 160125
instrumente vizatimi 160041 blloqe
vizatimi 160273 penela / furça piktore
160050 furça piktore 160216 kanavacë
piktore 160347 letër për pikturë &
kaligrafi 160022 dosje dokumentesh
160361 mbajtëse dokumentesh 160085
dosje 160392 mbulesa mbrojtëse librash
160018 mbajtëse librash 160249
faqeruajtës 160340 mbajtëse pasaportash
160246 qese / zarfa letre ose plastike për
paketim 160396 qese blerjesh letre ose
plastike 160409 qese ushqimore letre ose
plastike 160280 kuti letre ose kartoni
160282 zarf / kuti letre për shishe
160304 ambalazh letre për shishe 160365
material mbushës letre/kartoni për
paketim 160366 material mbushës
letre/kartoni 160279 letër nga masa druri
(bazë) 160130 letër dhurate / letër
paketimi 160285 ambalazh blister plastik
160406 nyzona me flluska për mbrojtje
160218 film plastik për ambalazh
160288 fletë celuloze për ambalazh
160339 letër e dyllosur (për produkte të
veçanta) 160355 fletë thithëse për
paketim ushqimi 160270 kalendarë
160186 peshqirë / mbulesa tryeze letre
160295 peceta letre 160373 rripa dekori
tavoline letre 160200 mbulesa tavoline
letre 160254 tapete tavoline letre 160038
bileta (për evente MVB).

18 - 180124 çanta 180118 çanta sportive
180076 çanta plazhi 180077 çanta dore
180020 çanta shkolle 180084 çanta
udhëtimi 180085 valixhe 180133
valixhe me rrota 180057 shpinore

180151 valixhe smart 180138 kubikë organizimi valixhesh 180144 organizatorë valixhesh 180128 etiketa valixhesh 180069 portofola 180126 mbajtëse kartvizitash 180125 mbajtëse kartash 180113 mbajtëse çelësash 180152 varëse metalike portofoli 180031 kordon lëkure 180071 çanta marketi me rrota 180089 kuti prej lëkure 180091 kuti & kasete lëkure 180023 kuti lëkure për produkte luksoze 180093 kuti kozmetike bosh 180041 dekorime lëkure 180042 imitim lëkure 180145 lëkurë vegane 180149 lëkurë mycelium (material ekologjik) 180039 lëkurë e papërpunuar ose gjysmë e punuar 180065 korniza strukturore çantash 180150 korniza për portmonedha 180086 doreza valixhesh 180131 mbajtëse dore çanta 180043 çadra 180045 çadra dielli 180051 mbulesa çadrash 180068 doreza çadrash 180018 korniza çadrash 180030 qafore kafshësh 180135 veshje për kafshë 180054 mbulesa kafshësh 180005 leshe lëkure për kafshë.

20 - 200041 mobilje 200037 mobilje zyre 200070 tavolina 200188 tavolina metalike 200050 karrige / ulëse 200184 divanë 200183 divanë të mëdhenj 200036 tavolina pune 200180 tavolina shkrimi 200083 tavolina vizatimi 200320 gardëroba / dollapë rrobash 200014 dollapë / kuzhineta 200309 rafta librash 200024 rafta biblioteke 200191 rafta magazinimi 200303 njësi raftesh 200108 rake / struktura raftesh 200062 rafta për dosje 200044 dollapë dosjesh 200043 dollapë indeksimi 200292 mbajtëse revistash 200256 kuti / arka për lodra 200207 arka / koshë jo metalikë 200128 kasa / arka magazinimi 200347 dollapë për valixhe 200271 jastëkë për kafshë shtëpie 200007 shtrat për kafshë shtëpie 200079 dyshekë 200157 jastëkë 200078 jastëkë dekorativë 200223 buste prej druri, dylli, gipsi ose plastike 200239 figurinë prej druri, dylli, gipsi ose

plastike 200187 statuja prej druri, dylli, gipsi ose plastike 200205 vepra arti prej druri, dylli, gipsi ose plastike 200365 kupa statujore përkujtimore prej druri/dylli/gipsi/plastike 200367 kupa çmimesh prej druri/dylli/gipsi/plastike 200006 kafshë të mbushura (dekor, jo lodra) 200151 mobile varëse dekorative 200225 korniza fotografish / ilustrimesh 200190 korniza / profile për korniza 200261 pllaka pasqyre 200193 pasqyra 200013 xham i argjendosur (pasqyra) 200333 shtylla flamuri dore jo metalike 200253 tabela druri ose plastike 200096 pankarta / targa druri ose plastike 200244 kuti postare jo metalike 200068 kontejnerë jo metalikë për magazinim/transport 200315 kuti druri ose plastike 200100 kontejnerë plastikë për paketim 200072 tabaka jo metalike 200362 kuti jo metalike për letërpeceta 200084 mbajtëse peshqirësh 200145 paleta transporti jo metalike 200199 punime shporte/prej shkopinjeve 200233 guaska (material dekorativ) 200005 qelibar i verdhë.

21 - 210045 shishe 210144 shishe sportive 210289 flaska 210046 termusë 210325 kuti drekë 210261 kuti ftohëse portative jo elektrike 210220 filxhanë 210318 filxhanë letre/plastike 210319 gotë pijeje 210232 kupa 210291 kupa birre 210235 pjata 210208 pjata serviri 210421 tasa supash 210203 tasa sallate 210058 tabaka 210267 tabaka shtëpie 210244 kuti ëmbëlsirash 210317 kuti për biskota 210292 set vaj/uthull 210063 dekanterë 210371 nën-pjata (jo letër) 210224 arka kursimi 210376 arkë monedhash koleksion 210447 kupa përkujtimore 210450 kupa çmimesh 210190 vazo 210133 vazo lulesh 210279 tabela porcelani/qelqi 210044 sfera dekorative 210098 kristal 210189 enë porcelani 210129 enë qeramike koleksione artizanale 210157 majolika 210285 figurina 210427 figurina për

torta 210217 statuja 210234 vepra arti koleksione arti

25 - 250194 bluza t-shirt 250130 këmisha 250089 xhaketa 250086 veshje (term i përgjithshëm) 250022 pantallona 250156 pantallona 250102 xhupa 250020 pallto / mantelet 250176 kostume 250033 fustane 250189 pizhame 250041 geta / rroba elastike 250036 çorape 250071 të brendshme femrash 250119 të brendshme 250192 sutenë ngjitëse 250126 rroba banje 250125 rroba banje meshkuj 250104 veshje plazhi 250105 këpucë plazhi 250005 pantofla plazhi 250023 çizme 250044 këpucë 250007 çorape sportshe 250172 atlete sportive 250132 bluza sportive 250065 doreza ciclizmi 250099 maskat e fytyrës jo mjekësore (veshje) 250012 kapuçë / kapele 250142 kapele 250185 kapele 250032 shallë 250043 shalle / mbulesa 250108 poncho 250168 ngrohëse këmbësh 250160 doreza të trasha 250085 doreza 250177 atlete gjimnastike 250048 jelekë 250109 mbrojtëse nënveshjesh 250097 doreza mal.

27 - 270011 qilima, tapete 270003 bar artificial 270008 tapete dere 270002 mbulesa dyshemeje 270006 mbajtëse / tapete 270012 antirrëshqitëse 270020 tapete yoga 270004 tapete gjimnastike 270001 tapete banjoje 270010 tapete makine 270025 tapete gome 270023 linoleum 270007 letra muri 270022 mbulesa muri tekstile 270013 dekor muror jo tekstil

28 - 280151 arusha pellushi 280235 lodra pellushi 280208 lodra të mbushura 280024 lodra 280219 figura lodrash 280218 modele lodrash 280163 automjete lodër 280210 lodra pellushi me batanije 280078 lojëra tavoline 280079 lojëra 280270 lojëra me letra 280191 lojëra me letra (deck) 280269 lojëra karta koleksionuese 280245 karta koleksionuese loje 280156 lojëra tavoline 280287 lojëra edukative 280168

puzzle 280114 lojë tavell 280055 lojë shah 280056 fusha shahu 280049 dama 280057 fusha dame 280214 konsola videolojërash 280246 pajisje videolojërash 280256 konsola dore 280228 joystick për videolojëra 280217 game controllers 280243 lojëra portative me funksione telekomunikimi 280215 lojëra portative me ekran LCD 280224 kontrollere për lodra 280119 zbukurime për pemë krishtlindjeje 280096 borë artificiale për pemë 280039 këmborë për pemë 280029 mbajtëse qirinjsh për pemë 280006 pema sintetike krishtlindjesh 280120 crackers festash 280146 kapele feste letre 280012 ballona feste 280240 shpërthyes feste 280088 kukulla 280103 rroba për kukulla 280086 shtëpi kukullash 280041 kocka ndërtimi 280165 lojëra ndërtimi 280168 puzzle 280197 snowboard 280148 skateboard 280115 skuterë lodër.

29 - 290017 fruta të konservuara 290248 snacks me bazë frutash 290160 koncentre frutash 290025 fruta të ngrira 290145 fileto peshku 290196 peshk i konservuar 290267 zëvendësues mishi 290263 snacks me bazë mishi 290114 mish shpendësh i përpunuar 290152 perime të konservuara 290066 supa me bazë perimesh 290247 koncentre perimesh 290265 ushqime perimesh për fëmijë të vegjël 290205 krem perimesh 290249 shpërhapje perimesh 290265 snacks me bazë perimesh 290053 shpërhapje yndyrore 290258 pektinë 290024 reçel 290048 xhele ushqimore 290155 puré molle 290178 milkshake 290164 produkte qumështi 290064 kos 290172 aloe vera e përpunuar 290218 qumësht bajamesh 290220 qumësht kokosi 290223 qumësht orizi 290225 pije me bazë qumështi kikiriku 290082 vaj susami 290091 vajra ushqimore 290201 vaj ulliri ekstra i virgjër 290084 vaj palme 290090 vaj ulliri 290060 farra të përgatitura 290204

arra të përpunuara 290203 arra me shije
290242 arra të karamelizuara 290116
bajame të bluara 290021 kokos i tharë
290157 misër i përpunuar 290010 gjalpë
kokosi 290121 yndyrë kokosi 290023
koncentrate lëngjesh 290183 supa
290099 përgatitje për supa 290056 turshi
290257 xhenxhefil turshi 290070 xhele
ushqimi 290056 petulla patatesh 290020
lakër e fermentuar 290028 kastraveca
turshi.

30 - 300026 kafe 300037 çaj 300024
kakao 300038 çokollatë 300151 krem
çokollate 300016 biskota 300042
ëmbëlsira / sheqerna 300190 karamele
300114 kokoshka 300248 snacks me
drithëra 300218 batonë drithërash
300119 snacks me bazë orizi 300003
makarona 300103 nudle 300217 salcë
makaronash 300046 akullore 300062
sorbete 300239 akullore të ngrënshme
300043 kripë 300041 salca/erëza
300054 erëza 300088 salca (ketchup)
300022 uthull 300091 miell misri
300059 drithëra 300195 përgatitje
drithërash 300136 mjaltë.

32 - 320031 Pije jo-alkoolike, 320058
Pije freskuese / gazuara, 320050
Smoothie, 320010 Lëngje frutash, 320044
Nektarë frutash, 320062 Limonada,
320035 Ujë i gazuar, 320015 Ujë mineral,
320007 Ujë pijesh, 320061 Pije me fruta
të thata, 320009 Esenca jo-alkoolike për
pije, 320008 Përgatitje për pije jo-
alkoolike, 320067 Pije energjike, 320045
Pije izotonike, 320054 Pije sportive me
proteina, 320071 Pije xhenxhefil, 320029
Sorbete të pijshme, 320027 Pije
bajamesh, 320055 Pije me bazë orizi,
320053 Pije me bazë soje, 320052 Koktej
me birrë, 320002 Birrë, 320065 Birrë jo-
alkoolike.

35 - 350039 reklamim 350047 shërbime
agjencie reklamuese 350177 reklamim
online 350028 shpërndarje mostrash
350121 demonstrim produktesh 350122
reklama outdoor 350062 prodhim

teleshopping 350137 prodhim videosh
reklamuese 350178 krijim identiteti
marke 350106 marketing 350155
kërkime marketingu 350187 vendosje
produktesh në mjedise virtuale 350151
marketing me influencer 350150
marketing i targetuar 350112 optimizimi
i trafikut të website 350041 kërkime
biznesi 350031 studime tregu 350020
